

Procesverbal

Nga seanca e VII-të (shtatë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 02.08.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e VI-të e Kuvendit...
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Komunës së Dragashit, për vitin e përfunduar më 31.12.2017,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Realizimit të Buxhetit të Komunës, për Janar-Qershor/2018,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit zë Zyës s Lokale të Komunitetit dhe Këthimit, për vitin 2017,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për Ankand Publik të makinave jo funksionale të Komunës së Dragashit,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës në pronësi komunale,
7. Shqyrtimi i Kërkesës së KF "Opoja", për mbulimin e shpenzimeve, dhe
8. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarinimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse nuk ka, miratohet, njëzëri, rendi i ditës.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...?

z.Zinaida Elmazi- Unë desha të propozoj edhe një pikë të rendit të ditës, pasi se tani jemi në momentet e organizimit dasmave të përcjllura me tollovi të mëdha, parkime të jashtë ligjshme, bllokime të rrugëve e gjëra tjera të cilat ndikojnë në aspektin e sigurisë?

Kryesuesi- Tash më e kishim miratuar rendin e ditës dhe Procesverbalin dhe vazhdojmë me seancën...

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Pra, vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin e Raportit të Auditimit..., hapim diskutimet?

z.Laurat Krasniqi- E kam lexuar Raportin e Auditimit i cili është material i gjerë e ku ka probleme të ngritura dhe çështje me interes për komunitetin. Në material vërhen pa rregullësi dhe kritika në llogari të qeverisjes së kaluar. Unë do t'i përmendi disa kritika që i kam vërejtur e që janë më të rëndësishme se sa tjerat. Pyetja e parë është për 41 mijë euror të cilat janë paguar e të cilat askush nuk i ka pranuar?! Pra, Komuna e ka paguar këtë shumë për punët të cilat nuk i pranuar askush?! Këtë e thekson Auditori në Raportin e vetë. Po ashtu, Auditori ka vërejtur se nga 49 mijë euro të të hyrave vetanake nga pagesa e dënimeve në trafik. Gjithashtu, edhe asfaltimi i rrugës Restelicë-Strezimir në vlerë prej 100 mijë eurove, është realizura në vlerën 41 mijë euro e pagesa është nërë për 100 mijë euro?! Edhe te mallërat e shërbimet kemi dallim të madh në hargjimin e tyre, duke pasur parasysh se ka qenë periudha e fushtave zgjedhore, që do të thotë se prona apo paraja e Komunës ka qenë në funksion të fushatës zgjedhore të një partive politike e që do të duhej të ishte vërejtje për këtë qeveri aktuale.

z.Samidin Xheladini- Sot në Kuvend e kemi materialin e gjerë të cilin, shpesh-herë, e kërkojmë dhe kërkoj që secili të jep kontributin për tejkalimin e mangësive e mos të them keqpërdorimeve të cilat duhet eliminuar në të ardhmen. Meqenëse matyreiali është i gjerë kemi mundur t'a ndajmë në 2 seanca, për të pasur më shumë kohë për debat. Sa i përket Raportit, auditorët janë mundur të bëjnë të gjeturat gjatë vitit 2017 në kuptim të menaxhimit të Komunës nga personat e angazhuar në organet komunale. Raporti, i cili përmban 43 faqe, në masë maksimale, është fokusuar në sugjerimet që duhet të bëhen për t'u tejkaluar keqpërdorimet dhe keqë-menaxhimi i mjeteve publike. Sipas Raportit, shifet se ka mjaft vërtje e sugjerime lidhur me eliminimin e keqë-menaxhimit me paranë publike, si dhe shkallë e ulët e realizimit të buxhetit e kjo është vetëm 41% e realizimit të buxhetit, që do të thotë shuma e paraparë prej afro 3 milionë eurove është realizuar në 1,7 milionë euro e kanë ngel pa u realizuar mbi 1,2 milionë euro të cilat kanë shkuar në suficit. Kategoria e pagave është realizuar më së shumeti, duke u realizuar 99% e për investime kapitale kemi pasur në shtim prej 20% në vlerë prej 446 mijë euro apo 59% e buxhetit final. Pra, kur flasim për pagat, në këtë kategori kanë ngelur vetëm 9,00 euro. Ndërkaq, te mallërat e shërbimet, dinamika e realizimit të mjeteve nuk është në harmoni me planifikimin për 54% të realizuara gjatë 3-mujorit të fundit. Po ashtu, buxheti për subvencione e transfere ka shtim prej 10 mijë eurove e që nuk mjafton dhe nuk është planifikuar mirë nga Kuvendi. Ndërkaq, për projektin e asfaltimit të rrugëve Retelicë-Strezimir janë hargjuar vetëm 41 mijë euro nga 100 mijë eurot e parapara, si dhe nuk është realizuar kategoria e vendosjes së anësorëve në gjatësi prej 500 m. Njëri nga rekomandimet e Auditorit është se kryetari duhet të themelon komisione për pranim dhe përfundim të punimeve të pakryera nga ana e operatorëve ekonomik. Për këtë, me rëndësi është që ato komisione të monitorojnë punët, që nga fillimi e deri në përfundim të projekteve, sipas afateve të parapara e që mjetet të rikthehen prap në buxhetin e Komunës. Çështje tjetër është shkalla e ulët e realizimit të investimeve kapitale nga të hyrat vetanake në shkallë prej afro 60%, si dhe vërejtjet në regjistrimin dhe prezentimin e të hyrave vetanake. Çështje tjetër-nr.4 është menaxhimi jo adekuat i të hyrave vetanake nga të hyrat e tatimit në pronë, pasi se për 1/3 e të hyrave nuk kemi kurfar të dhëna? Çështja nr.5 janë pa qartësi e dhënies së pronës komunale me qira

ku theksohet se 87 njësi të pronës komunale shfrytëzohen pa kontrata, si dhe ekziston pronë komunale e cilave shfrytëzohet me kontrata të skaduar që nga viti 2012. Pastaj, te koha e stazhit të punës, sidomos në QKMF, janë hasur të gjetura të jashtë ligjshme në regjistra. Çështje tjetër është mungesa e dosjeve të të punësuarëve, për të gjithë punëtorët. Edhe te angazhimi i punëtorëve për shërbime të veçanta ka dobësi e lëshime e që Komuna mund të jetë subjekt i dënimeve nga organet e drejtësisë. Çështje tjetër është regjistrimi dhe prezantimi i gabuar i subvencioneve, siç ka dobësi edhe në menaxhimin e kontratave për pagesa të investimeve kapitale. Në vazhdim, kemi edhe anashkalimi i procedurave të prokurimit, që, nga 42 kontrata, 12 prej tyre kanë ndarjen e tenderëve që është e dëmshme për transparencën dhe eliminimin e konkurrencës në cilësinë e shërbimeve. Edhe te pranimi i regjistrimit të shpenzimeve kemi dobësi, siç ka dobësi në inventarizimin e pronës, siç kemi rastin e veturave të pa regjistruara të Komunës. Çështje tjetër është mungesa e procedurave të brendëshme në regjistrimin e pronës në vlerë nën 1 mijë euro. Në vazhdim, si vërejtje, kemi vonesat në regjistrimin e parave të gatshme me vonesë të faturave prej madje 6 muajëve. Po ashtu, ka vonesa në pagesën e faturave e që janë 17 raste të tillë në vlerë prej afro 5 mijë euro të cilave u ka skaduar afati prej 30 ditëve për pagesë, që do të thotë se këto fatura të pa paguara do t'a ngarkojnë direkt buxheti e vitit 2018. Vërejtje tjetër e Auditorit është mos zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak e që thekson se është zbatuar vetëm një rekomandim, 2 kanë qenë në proces dhe 12 të tjera nuk janë zbatuar e që theksohet se në vitin 2015 janë dhënë 19 rekomandime e që për atë vit 2 janë zbatuar, 4 kanë qenë në procedurë dhe 13 të pa zbatuara. Edhe Komisioni i Auditimit nuk është kompletuar e që do të ishte në shërbim të ndihës kryetarit e kjo le të jetë çështje urgjente.

z.Refik Latifi- Në Raportin e Auditorit Gjeneral kam vërejtur se i ka dhënë disa rekomandime lidhur me pushtetin lokal në mandatin e kaluar. Shqetësimi im kryesor është krahasimi i buxhetit 2016 me atë 2017. ku Komuna në vitin 2017 ka hargjuar 82% të buxhetit final, që ka qenë mjaft keqë për performancën e Komunës, në krahasim me vitin 2016. Shpenzimet totale në vitin 2017 dhe dobësitë më të mëdha kanë qenë investimet kapitale ku është investuar më së paku-59% investime të realizuara. Nga investimet kapitale, prej rreth 3 milionë euro, janë realizuar 1,7 milionë euro e kjo do të thotë se realizimi i investimeve kapitale ka qenë i dobët me performancë po ashtu të dobët. Po ashtu, edhe një vërejtje e dhënë rreth realizimit total të të hyrave vetanake e në tabelën e dhënë nuk janë përfshirë të haryt nga dënimet në trafik në shumë prej 28 mijë euro, dënimet e shqiptuara përmes gjykatës në shumë prej 9 mijë euro, si dhe të hyrat e realizuara nga Ekonomia e Pyjeve në shumë prej afro 11 mijë euro. Këto janë disa nga rekomandimet e dhëna nga Auditori dhe e keqja më e madhe është se, qeveria e kaluar, nuk ka ndërmar asgjë rreth përmirësimit të këtyre rekomandimeve të dhëna edhe më parë?!

z.Velid Haxhisin- Fillimisht, po theksoj se te formulimi i kësaj pike nuk është dashur të qëndron miratimi i këtij Raporti, nga se nuk kemi se çka të miratojmë, por vetëm të shqyrtojmë, pasi se në pyetje është Raporti i një instance më të lartë. Pra, mund t'a shqyrtojmë e këtë edhe po e bëjmë dhe nuk ekziston qeveri komunale apo kryetar për të cilën Auditori nuk do të gjente vërejtje, nga se kjo

është në natyrën e njeriut të bëhen edhe gabime e detyra e auditorëve ka qenë të gjen gabime dhe konstaton ato. Problemi qëndron në atë se se për këto vërejtje nuk ekziston gatishmëria, përkatësisht nuk janë ndërmar hapa për evitimin e tyre? Kjo më shumë vlen për mandatin e kaluar e që ne duhet të besojmë se kryetari aktual do të ndërmer masa për përmirësimin gjendjes dhe implementim të vërejtjeve të dhëna përmes Planit. Unë përpiqem që të gjej disa gjëra në të cilat ekzistojnë dyshime. Psh. Në fq.22 thuhet pagesa në shumë prej 1.192 euro – shërbime tjera të kontraktuara që qenkan paguar nga kategoria e mallërave e shërbimeve e cilat në të vërtetë janë ato shërbime të kontraktuara? Auditori thekson se kjo shumë është dashur të paguhet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve e që pra është dashur të bëhen ndryshime? Pra, këtë bëhet fjalë për një mosmarrveshje e cila vërhet lehtë. Sidoqoft, apeloj në kryetarin që të punnom në aktivisht në implementimin e Planit e që këto gabime të bien në minimum.

z.Vehbi Nazifi- Para nesh e kemi Raportin e Auditorit i cili i dërgohet kryetarit i cili është voluminoz. Për këtë, hartuesi i Raportit është munduar që edhe neve, sado-kudo, të na lehtësohet puna që të na ofron këtë dokument me rekomandime në letër dhe se rekomandimet janë të qarta dhe të zbatueshme. Siç theksova edhe më herët, kryetari ka bërë punë të mirë që këtë Raporti ia ka përcjellur Kuvendit, që edhe ne, si Kuvend, të njoftohemi se çka ka ngjarë gjatë këtij procesi dhe cilat janë të gjeturat lidhur me funksionimin pushtetit lokal. Është normale se ka të gjetura e që do të ketë edhe në tëa rdhmen dhe është mirë që ne, si Kuvend, të japim kontributin tonë aq sa mundemi që të evitohen këto të gjetura përmes rekomandimeve të dhëna. Unë e kam hapur dhe lexuar faqen e Auditorit, duke lexuar edhe rekomandimet e dhëna për komunat tjera dhe mund të them se, edhe përkundër të gjetura, ne si Komunë, jemi në pozitë më të mirë, duke u ranguar në vendin e dytë për performancë të mirë në nivel të Republikës së Kosovës,. Pra, nuk është se jemi keqë, por rekomandimet duhet t'i zbatojnë dhe, siç jemi në dijeni, kryetari tash më është duke i implementuar ato e obligimi ynë është që, vitin tjetër, të jemi më të mirë sa i përket performancës komunale.

z.Zaim Hajredini- Materiali që po shqyrtojmë është i gjerë dhe me të gjetura e rekomandime, por vetë fakti se e kemi në rend dite dëshon se kryetari është duke punuar reth gjetjes së zhgjedhjeve së tyre. Në bazë të Raportit, mund të thuhet se probele të caktuar janë përcjellur, nga viti në vit, dhe ajo që dëshiroj të theksoj është që t'i japim përkrahje të parezervë kryetarit, që të përmirësohen e evitohen këto të gjetura e gabime. Është fakt se ka lëshime e gabime të caktuara nga ekzekutivi i Komunës e ne, si pushtet legjislativ, duhet të jemi të qartë në këtë drejtim që të jemi organ i cili bashkëpunon. Ne dijmë mirë se viti i kaluar ka qenë vit i zgjedhjeve dhe se ne, si Kuvend, nuk kemi mundur të kontrollojmë situatën sa i përket shpenzimit të buxhetit dhe se ka pasur shpenzimit të ulët deri në 6-mujorin e tij, e gjatë asaj periudhe, Kuvendi nuk ka pasur pasqyrim të qartë të shpenzimeve. Prandaj, është normale se pa qasje dhe monitorim mund të ngjajnë gabimet dhe lëshimet bë hargjimin e mjeteve, që shpresojë se, duke pasur kolegialitetin tonë dhe bashkëpunimin, rastet e gabimeve të tilla nuk do të ngjajnë. Shembull për këtë është pika e radhës ku e kemi Raportin 6-mujor të realizimit të buxhetit e ku mund të vërhet dallim i madh në shpenzime dhe shtim në

implementimin e investimeve kapitale, në krahasim me vitin paraprak. Prandaj, i rekomandoj kryetarit që, këto rekomandime të dhëna nga Auditori, t'i kupton seriozisht, pasi se ato indirekt kanë të bëjnë edhe me Kuvendin. Sa i përket bashkëpunimit, unë shpresoj se, bashkrisht, do t'i evitojmë dobësit e theksuara në Raport e jemi që, bashkrisht, t'i evitojmë gabimet e konstatuara.

z.Nexhat Isufi- I përkrahi parafolësit, nga se ka se çka të diskutohet kur është fjala për Raportin e Auditorit Gjeneral dhe shumicën e saj, se çka mendova të theksoj, e theksuan parafolësit dhe se vërejtjet e dhëna duhet kuptuar seriozisht, nga se janë nga aspekti profesional. Por, ajo që desha të theksoj është që të gjeturat e Auditorit të kuptohen seriozisht nga kryetari për zbatim të tyre për vitin në vijim. Vërtetë, shqetësim e ngritura nga Auditori janë për të mirën e qytetarëve tonë e këto janë obligimet tona, që gabimet e gjetura të evitohen, nga viti në vit, janë përcjell nga vitet paraprake. Pajtohem plotësisht me z.Velid H. se, edhe përkundër konstatimeve të dhëna në Raport, obligimi i kryetarit dhe organeve tjera komunale është që të evitohen dobësit, siç më gëzon fakti se, sipas performancës, jemi radhitur si komunë e dytë e vërejtjet e dhëna të merren seriozisht në të ardhmen.

Kryetari- Është fakt se Auditori Gjeneral ka konstatuar dobësi të caktuara dhe se Raportin e ka publikuar në faqen e vetë zyrtare, që opinioni i gjerë të njoftohet me të gjeturat te ne. Ky material është në rend dite sot, nga se një numër prej jush e ka kërkuar që të trajtohet edhe në Kuvend, për hirë të transparencës sonë. Por, është e vërtetë, se sikurse ne, me vërejtje e lëshime ballafaqohen edhe organet tjera anekënd komunave dhe institucioneve të Kosovës. Në konstatimet e dhëna dhe diskutimet tuaja, unë po theksoj se është e vërtetë se, në vitin e kaluar dhe mandatin e kryetari paraprak, ka pasur vonesa në realizimin e investimeve dhe të buxhetit në tërësi në kode të caktuara të cilat vëshirë kanë mundur të realizohen. Me situara të këtilla janë ballafaquar edhe komuna tjera të Republikës së Kosovës dhe Qeveria ka vendosur që kode të caktuara buxhetore të eliminohen dhe nuk është në pyetje se qeveria paraprake lokale nuk ka dashur t'i realizon. Sa i përket gjetjes së pagesës prej 41 mijë eurove, fjala është për projektin e rrugës në Restelicë në bashkëpunim me MInfrastrukturës e jo konstatimi se është bërë pagesa e nuk janë kryer punimet, por fjala është për mjetet e realizuara për projektin i cili është 3-vjeçar e ne, si pushtet lokal, është dashur të sigurojmë mjetet tona për të mos shkuar në sificit. Sa u përket mjeteve të grumbuluara, nga tatimi në pronë, edhe këtu kemi të gjetura të caktuara të Auditorit e që duhet marr parasysh për të përmirësuar shkallën e inkasimit të mjeteve të parapara. Është e vërtetë se Zyra e Tatimit në Pronë vepron dhe bënë verifikime dhe regjistrime të objekteve, por ka edhe të gjetura të Auditorit që duhet pasur parasysh, pasi se kemi probleme të caktuara logjistike e teknike me numër të madh qytetarësh që nuk qëndrojnë në vendlindje e ka vonesa në regjistrimine pronave të tyre dhe inkasimin e mjeteve. Sa i përket pronës së Komunës, kjo është çështje e ndieshme e nuk është lehtë të përshkruhet vetëm me fjalë, por me veprime konkrete dhe, nëse gjendja analizohet, në këtë drejtim duhet pasur parasysh edhe kontestet që ekzistojnë lidhur me pronën komunale. Këtu kemi rastet që prona është e Komunës e objekti privat e që janë probele nga periudha e paraluftës dhe, siç e dini, lidhur me pronën komunale, kryetari jep propozime për Kuvend, por që situata nuk është e qartë sa duhet? Për këtë

edhe paraqiten probleme lidhur me pronën, si në grumbullimin e tatimit, në zbatimin e kontratave dhe shfrytëzimin e pronës komunale dhe, si të grumbullohet tatimi nga ata që e shfrytëzojnë pronën dhe tatimi nëse nuk kanë kontrata për shfrytëzim të tyre dhe është e logjikshme ajo që ka konsideruar Auditori, se, nga këto arsye, nuk shfrytëzohet pronë komunale. Pra, situata është e komplikuar. Ne kemi edhe konteste me AKP-në dhe Auditori ka të drejtë kur konston gjetje të tilla dhe jep rekomandime. E kemi prezente edhe çështjen e dosjeve që mungojnë e janë të hapura të punëtorëve e këto rekomandime kanë qenë në rregull dhe procedura e realizimit është në përfundim e sipër. Sa i përket bartjes së pronave, në kode dhe nënkode, po theksoj se kjo nuk është aspak e lehtë dhe nuk është kontestuese se janë bërë edhe disa gabime. Edhe mos inventarizimi i pronës së Komunës është njëra nga të gjeturat e Auditorit e kjo është si pasojë e mungesës së kapaciteteve tona, si dhe pasojë e mosregjistrimit jo të plotë të sajë. Unë, personalisht, pajtohem që regjistrimi i pronës të bëhet nga zyrtarët komunal me kompenzime të caktuara për këto punë. Ne jemi në situatë të pa lakmueshme kur duhet të angazhojmë punëtorë të caktuar e mos të sigurohet kompenzimi-shtesë për ta. Kjo më mbetet të angazhohem dhe të zbatoj rekomandimet e këtilla e mos të ngjan përsëritja në periudhën e ardhëshme. Sa i përket Komitetit të Auditimit, nuk qëndron ajo se nuk e kemi atë, pasi se ky është obligim ligjor e ne kemi të themeluar atë dhe atë e themelon kryetari i Komunës nga punëtorë të Komunës e kjo përshkruhet me ligj. Sipër theksova edhe më herët, niveli i grumbullimit të mjeteve të tatimit në pronë dhe shfrytëzimi i pronës nuk është në nivel të kënaqshëm, por që në periudhën e ardhshme, do të tentojmë t'a përmirësojmë. Sa i përket Komunës, ne kemi hartuar Planin për realizimin dhe eliminimin e këtyre rekomandimeve dhe atë e kemi përcjell në Zyrën e Auditorit Gjeneral, të cilat janë miratuar. Kjo do të thotë se jemi në procesin e eliminimit të të gjitha rekomandimeve të cilat i ka konstatuar Auditori. Sa u përket investimeve kapitale, në pyetje janë edhe "pagat jubilarë" të punëtorëve dhe çështje tjera që realizohen nga përmbaruesit privat dhe është e mundëshme që ato mjete të paguhen nga pozicioni i mallërave shërbimeve punëtorëve të cilët e gëzojnë këtë të drejtë me punë mbi 10 vjet e ky është obligim ligjor, që edhe përkundër këtyre ngarkesave financiare, konstatoj se ballfaqohemi me stabilitet financiar. Këto forma të pagesës nuk janë paraparë me buxhet, por që ndikojnë direkt në te. Pra, këto rekomandime të Auditorit i kuptojmë seriozisht, nga se edhe punën e tyre e kontrollojnë organet kompetente e obligimi i ynë është që t'i zbatojmë.

Kryesuesi- Kalopjmë në miratimin e rekomandimeve dhe kush është "për"...? 22 vota nga delegatët prezent, që pra, miratohen njëzëri.

z.Samidin Xheladini- I miratuam këto të gjetura të Auditorit e që janë të bazuara në dëshmi dhe fakte, që ka nevojë për elimin të keqpërdorimeve nga menaxhuesit dhe, me këtë rast, kërkoj nga organet e drejtësisë, si dhe nga organet policore që të ndër marrin hapa konkret, që psh.nuk është në rregull që punëkryesit të punimeve t'i bëhet pagesa e tyre pa i përfunduar ato sipas projektit?! Mua më vjen keqë që nuk ka reaguar komuniteti shumicë në këto fakte, por, si duket, dhe më vjen keqë se edhe komuniteti jo shumicë është në njëfar koalicioni lidhur me këtë me partinë në pushtet dhe, për

këto dobësi, po heshtet?! Nuk është dobësi vetëm në lëshime, por ato lëshime pushteti i kaluar, tri herë radhazi, mjetet i ka dërguar në suficit, pasi se kemi ndarë 4 milionë euro e, në anën tjetër, fshatrat tona po ballafaqohen me mungesën e ujit të pijes, mungesë të infrastrukturës rrugore dhe nevojave tjera elementare, sepse neve po na këthen në suficit nga 2 milionë euro?! Kjo është tejet shqetësuese dhe për këtë ndjej frustrim dhe mendoj se duhet të japim kontributin maksimal që këto çështje t'i qojmë deri në fund dhe, mund të them, se kryetari është në proces që këto çështje t'i zgjidh. Unë nuk dëshiroj të akuzoj askend, apo të shof dikend të akuzuar, por dëshiroj të dëshmoj se në këtë Komunë ekzistojnë ligjet dhe rendi.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe në kuadër të kësaj pike tani e kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportin e realizimit të buxhetit, për periudhën 6-mujore Janar-Qershor 2018, hapim diskutimet...

Kryetari- "Bazuar në nenin 58 pika J të Ligjit 03-L/40 mbi Vetëqverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.20/2008) dhe nenit 45. Të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimine Financave Publike dhe Përgjegjësiive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.27/2008), paraqes një përmbledhje të shkurtër për realizimin e buxhetit Janar-Qershor/2018. Raportet financiare tregojnë informacione lidhur me buxhetin, rjedhën e parasë së gatëshme, të hyrat, pagat, shpenzimet e mallërave e shërbimetet, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet dhe shpenzimet për investime kapitale. Ky Raport financiar prezanton të hyrat dhe shpenzimet e muajëve Janar-Qershor/2018 dhe bënë krahasimin me muajt e njëjtë të 2 viteve paraprake. Buxheti për vitin 2018 është miratuar në Kuvend në shumën prej 8.069,990,00 euro, pas bartjes të të hyrave vetanake të pa shpenzuar të vitit 2017 në shumë prej 637,935,10 euro dhe të hyrat nga Fondi i Donatorëve të vitit paraprak në shumë prej 13,028,65 euro, kështu buxheti komunal, për periudhën raportuese, arrin shumën prej 8.720,953,75 euro. Buxheti komunal, në këtë periudhë raportuese, është shpenzuar në shumë prej 2.954,200,26 euro dhe, në krahasim me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak, është shpenzuar 23,28%. Pagat e shtesat-pagat janë më të larta, në krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak, për arsye të rritjes së pagave prej 4% dhe rritjes së përvojës së punës. Shpenzimet për mallëra e shërbime- janë më të larta për 37,10% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo tregon një formë të mirë të shfrytëzimit të buxhetit. Shpenzimet komunale – janë më të larta për 5,35%, në krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak. Në këtë rritje ka ndikuar impianti për pastrimin e ujërave në fshatin Kapre. Subvencionet dhe transferet – janë më të larta për 21,13 % në krahasim me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar. Në këtë vit janë bërë më shumë pagesa, për shkak të disa rasteve emergjente që janë paeraqitur në Komunën tonë. Shpenzimet për investime kapitale, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, janë më të larta për 1.639,91 euro. Në këtë kohë të raportimit të shpenzimeve, investimet kapitale janë në fazën e zhvillimit të punimeve. Deri tani janë përfunduar 25 kontrata dhe 43 projekte janë në procedurë të tenderimit. Të hyrat vetanake janë më të larta për 10,78 % me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në

tabelë shihet se çertifikatat e lindjes, vdekjes, kurorëzimit nuk janë në nivel të pritshëm, por programi këto i regjistron si taksa tjera të Ofiçarisë”.

z.Laurat Krasniqi- Unë, Raportin e kam lexuar detalisht dhe ajo, që më ra në sy, ishin shpenzimet e varrimit. Ne në seancën e kaluar e miratuam, unanimisht, Vendimin lidhur me këtë e në këtë Listë këtu qëndrojnë 1.400,00 euro e që qenka bëra pagesa për shpenzime të tilla? Unë e kam vizituar KBIslame në Dragash dhe kam biseduar me ata e më kanë njoftuar se, deri tash, nuk kanë lëshuar asnjë vërtetim lidhur me këtë. Pra, për cilin institucion keni vendosur për këtë pagesë, duke pasur parasysh se KBI, përkatësisht, hoxhët, janë kompetent për varrosje e jo zyrtarët komunal? Unë nuk e di se si është e mundur të lejohen mjetet pa vërtimin e KBIslame e kjo është në kundërshtim me rregullat dhe bazën ligjore. Për këtë kërkoj sqarim?

z.Samidin Xheladini- Raporti 6-mujor do të ishte, më së miri, të ishte sipas dinamikës 50 : 50%, që do të thotë se hargjimi i buxhetit të jetë në harmoni me projektet e realizuara 50% në nivel komunal. Këtu kategorit tjera, siç janë mallërat e shërbimet dhe shpenzimet komunale e lukse tjera, duhet të zvogëlohen maksimalisht e të shtohen investimet kapitale. Pra, Komuna duhet të fokusohet në 2 gjëra, që të zvogëlon shpenzimet e veta e të shton investimet kapitale. Dua të theksoj se kryetari duhet të ketë parasysh faktin se ne jemi komunë me lartësi të madhe mbidetare e që nga shtatoritëtori fillojnë edhe të reshurat e që investimet kapitale duhet realizuar në kohë të përshtatshme për t’u përmbyll projektet. Kërkoj shtim të vemendjes lidhur me kategorinë e subvencioneve që do të gjeneronte me hapjen e vendeve të punës. Kam edhe një pyetje për kryetarin e Komunës se shqyrtimi dhe rishikimi i buxhetit a do të ndikon në investime kapitale dhe ecurinë e realizimit të buxhetit për këtë vit?

z.Zaim Hajredini- Mua më vjen mirë që vendimet tona të cilat i kemi miratuar janë në fazën e impelementimit. Nuk kam vërejtje në këtë Raport, pasi se është periudha 6-mujore dhe se kemi kontrata të cilat janë në procesin e nënshkrimit. Para disa muajëve patëm Raportin 3-mujor që mendoj se nuk ka dallime të mëdha në mes të dy intervaleve kohore. Sidoqoft, shifet se jemi në rrugë të drejtë, nëse bëhen krahasime me atë të periudhës së njëjtë të vitit paraprak, ku shifet ana pozitive e realizimit të buxhetit. Duke e pasur parasysh se këtë vit nuk do të ketë rishikim të buxhetit, do të kisha lutur kryetarin apo organet kompetente se, nëse vërejnë mjete të mbetura nga ndonjë projekt gjatë realizimit, do të ishte mirë që me miratim të buxhetit në Shtator, t’u dedikojmë atë, që mjetet mos të na shkojnë në suficit. Nuk e di se sa e kemi bazën ligjore t’u bëjmë këtë, por nëse kjo mundësi ekziston të bëhet me kohë, vetëm e vetëm, që të ruhen mjetet, për të mos shkuar në suficit.

z.Vehbi Nazifi- Raporti 6-mujor është që të njoftohemi ne si përfaqësues të qytetarëve me ecuritë buxhetore të parasë publike. Në bazë të asaj që është paraqitur në pasqyra tabelare, shifet se realizimi i buxhetit është në mënyrë të kënaqshme, nëse krahasohen me tabelat e vitit paraprak e që kjo dëshmon se kemi stabilitet financiar. Po ashtu, është pozitive se kemi shtim të të hyrave vetanake për afro 16 mijë euro e që është për çdo lavadatë.

z.Valon Shabani (DDEF-a)- U mundova t'i përfshijë disa sugjerime dhe pyetje e pyetja e parë ishte lidhur em shpenzimet e varrimit e që janë paguar nga kategoria e mallërave shërbimeve e këto mjete janë paguar sipas UA, për rastet e vdekjeve të anëtarëve të ngushtë të shërbyesëve civil e që ka të këtë të drejtë në nivelin e pagës mesatare, si kompenzim. Kjo do të thotë se është bërë pagesa për 5 zyrtarë civil të Komunës. Ndërkaq, sa u përket kompenzimit të shpenzimeve të varrimit, sipas Vendimit që është miratuar këtu, po theksoj se me atë Vendim ende nuk kemi filluar, pasi parashohim Marrveshje me Kblslame në Dragash. Sa u përket realizimeve të investimeve kapitale, mund të them se jemi intenzivisht në procesin e realizimit në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit e, sipas planeve, ka efekte pozitive e që mund të shifet edhe në terren. Siç theksoi edhe kyretari, kemi 25 projekte të përfunduar dhe 43 të tjerë janë në procedurë e që do të thotë kemi edhe 300 mijë euro-shtesë për realizim. Njëri nga problemet është se, sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk do të kemi rishikim të buxhetit, pasi se është thënë se buxheti është planifikuar mirë e që nuk do të ketë nevojë të rishikimit. Ajo që ndoshta do të ndikon në këthimin e mjeteve në suficit është problemi lidhur me kompanitë private të cilat konkurojnë me çmime tejet të ulëta, nga çmimet e parapara, nga Prokurimi. Do t'a theksoj një rast në fshatin tim-Kuk ku kemi një projekt të vlerësuar 50 mijë euro e për atë kemi kompaninë e cila ka konkuruar me 36 mijë euro. Po ashtu, dua të theksoj se komuna e Jonë qëndron mirë lidhur me obligimet të cilat nuk i ka ndaj punëkryesëve, për dallim nga komunat tjera në Kosovë që i kanë realizuar kontestet përmes ekzekutuesëve privat edhe deri nga 200 mijë euro?! Ne nuk kemi pasur rastin që të ballafaqohemi me përmbarues privat, pos në një rast, kur kemi paguar 2.500,00 euro e që nuk ka qenë në tërësi për përmbaruesin, por për tërë lëndën e që ka qenë në gjykatë.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është "për"-13, "kundër"-8 dhe 0 vota "të përmbajtura", që konstatoj se miratuar Raportin 6-mujor financiar/2018.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Kalojmë në pikën e IV-të rendit të ditës-shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së ZLKKthimit, për vitin 2017, të cilin e keni kërkuar, hapim diskutimet...

z.Velid Haxhisin- Është mirë që, pas insistimit të gjatë, e kemi këtë Raport, pasi se kjo Zyrë është direkt përgjegjëse ndaj kryetarit e nuk është në kuadër të drejtorateve. Besoj se nga kjo Zyrë, në periudhën a aedhlëshme, do të kemi e Planin e Punës, pasi se tash më është vonë se ka kaluar gjysma e vitit, që besoj se, për të ardhmen, do t'a ketë praktikë që, regullisht, të na paraqet raporte sikurse edhe drejtoratet, që mos të jemi në situatë t'a kërkojmë ne. Raporti, si Raport, mund të jetë jetë i pranueshëm, por në te ka mjaft konstatime paushale. Psh.kur bëhet fjalë për pikën 3-plaçkitjet nga ana e kryesëve të panjohur nga Shqipëria, nëse hetimet nuk kanë treguar diçka, nuk mund të bëhen kualifikime, pasi se fjala për kryes NN?! Posaçërisht, lidhur me plaçkitjen e fundit në Restelice e që dihet se është zbuluar dhe se kryesi i veprës nuk është nga Shqipëria, por nga Restelica. Si duket, kjo Zyrë, nuk paska qenë në dijeni me këtë rast, edhe pse ka pasur takime me Policinë. Ky është vetëm

shembull i atyre konstatimeve paushale. Sidoqoft, mua më vjen mirë që, më në fund, të kemi një Raport të këtill të kësaj Zyreje.

z.Hajrudin Hoxha- Pajtohem me parafolësin dhe unë do të sugjeroja se kjo Zyrë është ndërlidhëse me kryetarin dhe me qytetarët. Te pika 8 theksohet se lidhur me centralin në Vraniç "ne u kemi dal në ball qytetarëve dhe i kemi dërguar në Prishtinë"? Kjo fjali, për mua, është e papranueshme se kur kanë shkuar atje e kush i ka pranuar, udhëhequr dhe i ka prezentuar si qytetarë të Vraniçit? Pra, është pak sa qesharake, sepse nëse ashtu drejtohen qytetarët për në Prishtinë, ata po shkojnë me vetëdëshirë, siç kemi pasur rastin me ujësjellësin në Restelicë kur kemi shkuar ashtu dhe na është dhënë vatura zyrtare dhe shkuam e erdhëm me duar të thata?! Për të ardhmen, nëse qytetarët ankohen, kërkoj që t'u delet në ndihmë dhe Zyra, s' bashku me ata, të shkon në Prishtinë, Prizren etj. e mos të shkohet në mënyrë paushale dhe, për të ardhmen, kërkoj të kemi Raport më të gjerë.

z.Selman Osmani- Nëse kjo Zyrë raporton, për herë të parë, kjo do të ishte normale që të ketë edhe gabime dhe besopj se zyra nuk do t'a kupton se këto kritjka janë të qëllimshme, por qëllim mira, që, në të ardhmen, të pranojnë kritikën dhe t'a formulojnë Raportin në mënyrë më të mirë. Në njëfar mënyre, ky Raport është vetëkritikë dhe, në esencë, është i pranueshëm, edhe pse aty ka lëshime caktuara, siç është ecuria financiare e Zyrës, e që mungon në Raport. Mendoj se zotëritë nga kjo Zyrë nuk do të hidhërohen nëse ju japim kritjka qëllim mira. Këtu nuk po e shoh Raportin periodik të Zyrës sa u përket kthimit të të këthyerëve, e kemi 6 raste, e për cilën periudhë është fjala dhe deri ku është arritur me të këthyerit? Pra, Raporti është i pranueshëm, por besoj se, në të ardhmen, do të jetë më konkret, me vërejtjet tona.

z.Nexhat Isufi- Vërtetë, nuk kemi pasur informacione të këtilla për këtë Zyrë dhe kam një pyetje për përfaqësuesin e kësaj Zyreje. Sipas këtij Raporti, theksohet se ka pasur 45 të këthyer që mund të dihen përmes Zyres e pyetja e ime ka të bëjë me verifikimin e këthyerëve, pasi se kemi shumë raste se kur vijnë-këthehen, ju ndërtohet shtëpia e pastaj, prap, këthehen atje, nga kanë ardhur?!

z.Zaim Hajredini- Ka qenë interesi i posaçm që të kemi këtë Raport dhe, më vjen mirë, që e kemi, edhe pse nuk e di se kush e ka hartuar? Një pjesë e këtij Raporti, më duket, të bënë kushtëzime e madje përdoret gjuha nacionaliste, që nuk është mirë, dhe se krijohet përshtypja se ne qenkemi kundër komunitetit jo shumicë, që nuk është ashtu. Në mes tjerash, përmendet Ambasada e Amerikës në Beograd, sikurse mos të ketë të tillë në Kosovë. Nuk përmendet EULEX-i, por UNMIK-u e që mua më ka penguar, nga se ne e pranojmë EULEX-in, që pra ka mjaft irealitet? Shumica e problemeve, që përmenden në Raport, janë probleme edhe të komunitetit shumicë. Nëse flitet për muzikën, e cila është e bujshme gjatë natës, kjo ngjan edhe në fshatrat tona. Nëse flitet për vjedhjet e theksohen si kryes NN e pastaj i etiketohen si vjedhje të qytetarëve të Shqipërisë, e vjedhje kemi edhe në trevën e Opopjës. Siç e dini, në më herët, kemi kërkuar sqarime nga Policia e që vjedhje ka

pasur në teritorin e Gorës, por edhe të Opojës e, në këtë Raport, nuk kemi statistika, por vetëm supozime e mendime?! Ndonjëherë, duhet të jemi vetëkritikë, pasi se, nëse thuhet se punësimi bëhet me njoftësi apo mosnjohje të gjuhës, atëherë unë do të pyes se çka ata-të Zyrës kanë bërë konkretisht që klanet e komunitetit të tyre të mësojnë gjuhën e komunitetit tjetër? Pra, çka keni bërë që komuniteti Goranë të kyçet në plan-programin arsimor të Republikës së Kosovës dhe sa ka të atillë të cilët marrin paga nga buxheti i Republikës së Kosovës e, në anën tjetër, fëmijët e tyre vijojnë mësimet me plan-programe të huaja-Republikës së Serbisë?! Të gjithë e dijmë se ne, si Komunë, ndajmë mjete në kuadër të mallërave e shërbimeve për mirëmbajtjen e shkollave, e ata nuk na njoftin-si Komunë! Nëse krijohet përshtypja se ne nuk e respektojmë komunitetin jo shumicë, parashtrohet pyetja se çka keni bërë ju për komunitetin tuaj?! Pra, dëshiroj të theksoj që mos të krijohen urrejtje ndëretnike e që duhet të bashkëpunojmë e të jemi në raporte të mira. Nuk është në rregull që KKomuniteteve, për shkak të disa çështjeve, e ka bojkotuar punën e tij dhe disa organeve komunale. Ne duhet të vazhdojmë të bashkëpunojmë, Raporti të jetë me sa më shumë statistika e tabela reth punëve të kryera, për periudhë të caktuar.

z.Zinaida Elmazi- Unë do të parashtroja një pyetje këtu në pikën 7 ku theksohet se ZLKKthimit e ka vizituar MKëthimit e ne dijmë se kjo Ministri është institucion e qe 4 vjet nuk qenka realizuar te ne asnjë projekt për të këthyerit, te ne. Nuk qenka ndërtuar asnjë shtëpi për të këthyerit e kemi mbi 40 të tillë të cilët presin realizimin e projekteve e që i plotësojnë kushtet. Dëshiroj të di se çfarë bisedash e marrveshesh keni pasur dhe çka ka premtuar Ministri dhe kur do të fillon realizimi tyre? E dyta, Komuna apo kryetari, duhet të ndikojmë më shumë te kjo Ministri që të hapen projekte për realizim në Dragash e jo të jemi "zorrë e verbër"? Nëse mund të ndërtohen shtëpi në Shtërpce, mund të ndërtohen edhe në Dragash?!

z.Samidin Xheladini- Unë do të dëshiroja sqarime se si funksionon kjo Zyrë, kush ka qasje në te, duke pasur parasysh se, siç dëgjuam, ajo nuk është në kuadër të asnjë drejtorati. Këtu e kemi pikën e cila thekson mos bashkëpunimin me KKomunitete e në atë Komitet, një kohë, nuk kanë marr pjesë as anëtarët tonë, kurse theksohet se është punuar në dëm të komunitetit jo shumicë?! Fillimisht, përmenden anëtarët në emër të Komitetit, e pastaj përmenden individët, e unë kam biseduar me të dy anëtarët e këtij Komiteti nga partia ime, dhe ata vetin e konsiderojnë e nuk kanë pasur çështje kontestuese. Për këtë, dëshiroj që të distancohem nga këto konstatime e të apostrofohen subjektet politike të cilat paskan bërë presione?! Këtu, në Raport, hartues është Mehmet Hamza-anëtar i Vakait, dhe pse pra keni bërë koalicion, nëse keni pasur aq presione dhe padrejtësi?! Ndërkaq, tani po na dërgoni Raportin me të cilin po na shqetësoni dhe nuk po dihet se çka po ngjanë? Mendoj se kjo Zyrë duhet të jetë serioze e të merret me çështjet të cilat i takojnë.

z.Granit Rifaj- Ky Raport, që nga rendi i parë e tek i fundit, është tejte tendencioz. Çështjet e vjedhjeve të pa zbuluara nuk guxohet të etiketohen me nacionalizëm, pasi se vjedhësi është vjedhës e nuk ka nacionalitet. Pika e parë thekson se ZLKKthimit, regullisht, ka marr pjesë në mbledhjet e

KKomunitete e, në anën tjetër, thuhet nuk ka marr pjesë në mbledhje të KKomunitete, në shenjë solidariteti me anëtarët e Komitetit?! Çfar solidariteti, nëse e kanë bojkotuar punën-pa arsye dhe të theksohet se çka është bojkotuar e të solidarizohemi të gjithë? Pastaj, theksohet se, disa anëtar të komunitetit shumicë në Kkomuniteteve, janë sjellë në mënyrë të pahijshme ndaj anëtarëve të komunitetit jo shumicë në KKomunitete e për këtë ekzistojnë procesverbale? Të gjitha këto insinuata po na dalin nga kjo Zyrë, pasi se ata, fillimisht, kanë marr urdhërat nga kjo Zyrë e pastaj kanë vendosur njëfar politikë?! Pra, kush ju kërcnon dhe bënë presione të theksohet konkretisht? Për këtë kemi organet dhe a ju besoni organeve? I kemi gjykatat, Policinë etj, dhe, nëse ka qenë ashtu, pse nuk jeni paraqitur atje? Çështja se komuniteti jo shumicë qenka mbivotuar me rastin e mini-hidrocentraleve dhe ajo se qenka njoftuar opinioni i gjerë, si: KFOR-i, UNMIK-u, OSCE-ja etj. janë si kërcnim e ata nuk janë kërcnim për shtetin e Kosovës e as për delegatët dhe kërcnimet kryesore ndaj Kosovës janë politikat e zyreve të Milosheviqit e që vijnë direkt në Zyrën tuaj?! Komuniteti jo shumicë duhet të dij se kur ka filluar ndërtimi i mini-hidrocentraleve, janë mbajtur debata në të cilat keni marr pjesë edhe ju, kurse ajo reth muzikës së bujshme, nuk ka vend në këtë Raport, pasi se askush, nga Opoja, nuk vejn që të bëj muzikë para dyerëve tuaja, pasi se, ata, jeni ju dhe fëmijët e nipërit tuaj, kurse tani paraqiteni se po ju pengojnë shqiptarët e muzikat janë në gjuhën tuaj?! Delegacioni nga Vraniçi ka qenë në Zyrën tuaj për t'i ankuar reth ndërtimit të mini-hidrocentraleve dhe ka kërkuar të ankoheni në instancat më të larta dhe ju pasket dal në ndihmë, duke i dërguar në Prishtinë e këtë problem e kanë pasur edhe banorët e Rapçës dhe dëshiroj të theksoj se, e gjithë kjo lojë reth mini-hidrocentraleve, ka qenë e inskenuar nga kjo Zyrë në bashkëpunim me strukturat përkatëse paralele të Serbisë! Çështje tjetër e cila theksohet është kontaktet me Zyrën e Bashkimit European e që kanë qenë lidhur me ndërtimin e mini-hidrocentraleve e që nuk keni hasur në ndonjë mirëkuptim? Fjala është për HC-të e "Renelual-Tahirit" e për këtë paskan biseduar, regullisht, me UNMIK-un i cili ka kërkuar informata reth problemeve në Dragash? Pasjat, n vazhdim, përmendet problemi me lapidarin e Adem Jasharit dhe, pikrisht këtu, ka lindur problemi, pasi se një numër i KKomunitete, kanë therksuar se figura e Adem Jasharit po pengojka në procesin e integritetit dhe unë ju them se Ai nuk paraqet kurrfar problemi e penges për integritetin dhe ju kemi lutur që mos të ofendoni, pasi se Ai paraqet personalitet tejet të rëndësishëm për ne. Juve duhet të ju ofendon Marko Gjuriqi e shumë Gjuriqa tjer të cilët i keni sjell në Gorë dhe, ky Raport, është ai raporti për të thënë se keni bërë Raport?! Prandaj, herëve tjera, të na sillni Raport i cili do të thekson se sa shtëpi keni ndërtuar për të këtyherit, sa i keni përkrahur bizneset, të këthyherit etj.

z.Artan Loshaj- Kjo Zyrë po tregon jo seriozitetin e sajë me një Raport 2-3 faqesh, por është mirë që kanë filluar pas 20 viteve të dërgojnë Raport, pasi se, në njëfar mënyre, janë dukur si "shtet në shtet"?! Ajo, askujt nuk i ka dhënë llogari, as Kuvendit, apo drejtorateve, apo kujt do qoft. Mua më intereson një çështje që dua t'ia parashtroj kësaj Zyreje, e ajo ka të bëj me të hyrat se kush i hargjon ato dhe për çfar? Edhe ajo se a ka kjo Zyrë të drejtën e shfrytëzimit të veturës, të cilën zyrtarët e sajë, duke e keqpërdorur, e kanë shëndërruar në pronë private për shfrytëzim 24-orësh. Unë, personalisht, i kam parë nëpër bankete, "Elkos" e qendra tjera tregtare. Prandaj, kërkoj nga kryetari që të ndërmerr

masa kundër zyrtarëve të saj, pasi se ata janë ndër keqpërdoruesit më të mëdhenjë të buxhetit të Komunës sonë. Ajo që theksohet, reth presioneve të disa anëtarëve të komunitetit shumicë ndaj atyre të jo shumicës, ne këtu jemi bashkarisht e të deklarohe mi se kush në kend ka bërë presion? Pra, mos të bëhen raporte të këtilla për interesa personale. Sa i përket dy gjuhësisë, ne gjithmonë kur gjendemi në shoqëri, ku janë 10 shqiptarë a 1 goran, ne gjithmonë mundohemi të flasim në gjuhën tuaj, vetëm e vetëm që ju mos të ndiheni keq.

z.Munir Jonuzi- Në këtë Raport po shofim vetëm probleme e jo edhe propozime për zgjidhje të tyre. Unë do të theksoja pikën 12 të Raportit, se Zyra, regullisht, i paska vizituar fshatrat e jo shumicës për t'u njoftuar me problemet që i kanë, si dhe grumbullimin e e propozimeve për investime kapitale dhe, pastaj, thuhet se përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë nuk janë të kënaqur me kryerjen e punëve të investimeve kapitale dhe paarshtroj pyetjen se a i keni lajmëruar shërbimet përkatëse, për të qenë, në të ardhmen, më mirë realizimi i projekteve. Pra, pse gjithkund theksohen këto probelme e nuk ka propozime për zgjidhjen e tyre?! Te pika 16 theksohet se te Zyra e saj nuk është paraqitur asnjë person i ri atdhesuar në vitin 2017, por që paska pasur kandidatë potencial të regjistruar përmes UNHCR-së dhe se ajo organizatë, bashkarisht me përfaqësuesit e ZLKKthimit, i paska vizituar të këthyerit potencial? Prandaj, parashtrohet pyetja se çka u bë reth kësaj çështjeje dhe çka duhet të dijmë ne-si delegat, kryetari apo të tjerët, për t'u siguruar këthim i sigurt e pa pengesa. Më herët, u theksua se kjo Zyrë i përgjigjet kryetarit, që është e saktë, por është përgjegjëse edhe ndaj KKomunitete dhe nuk është që të lehet në kryetarit të vendos se ado të parashtrohet Raporti në Kuvend apo jo, sepse, në përshkrimin e punëve të kësaj, Zyreje theksohet se ajo duhet të raporton në KKomunitete, në çdo 2 muaj, 6 muaj dhe në 12 muaj e që kisha kërkuar nga Zyrja të na njofton sipas përshkrimit të punëve të saj.

z.Arjeta Skeraj- Unë, si anëtare e KKomunitete, kur e kam lexuar këtë Raport, jam ndier mjaft keqë. Më herët, z.Velid H. ka qenë kryesues i KKomunitete dhe ne si anëtar asnjëherë nuk jemi kundërshtuar me njeëri-tjetrin e këtu theksohet se, për shkak të incidenteve, qenka njoftuar UNDP-ja, OSCE-ja, KFOR-i, UNMIK-u dhe institucionet tjera e unë nuk e di se a e kemi njoftuar ndonjë subjekt? Meqenëse ju, z.Velid H., keni qenë kryesues i KKomunitete, duhet të sqaroni këtu se a ka pasur incidente apo mosmarrveshje?

z.Velid Haxhisin- Unë, në cilësin e kryesuesit të KKomunitete, kamë dhënë dorheqje nga ky Komitet dhe, automatikisht, edhe nga KKSBJ-ja, por ka pasur ndjenja të presioneve verbale te anëtarët e komunitetit jo shumicë dhe është tjetër presioni verbal të përmendet në një situatë të ndieshme? Nga kjo situatë se nuk kemi mundur të balansohemi, unë pesonalisht-si kryesues, nuk kam mundur të duroj dhe kam dhënë dorheqje nga kryesuesi i këtij Komiteti. Pra, nuk ka pasur mirëkuptim të ndërsjell dhe për këtë, me gjasë, anëtarët e komunitetit jo shumicë në Komitet, janë ndier të sulmuar verbalisht, por që ka pasur sulme direkte verbale, unë këtë nuk mund t'a them?!

z.Uzair Hamza (ZLKKthimit)- Kishte mjaft vërejtje dhe unë nuk kam pritur se do të ketë kaq reagime. Nuk e di se a do të jam në mundësi që t'u përgjigjem të gjithëve në pyetje, nga se nuk e kam hartuar Raportin e unë jam Koordinator e z.Mehmet Hamza shef i Zyrës, por gjithsesi jam pjesë e Zyrës. Fillimisht, të theksoj se Zyra vepron sipas UA të QRKosovës 02/2010 ku i kemi përshkrimin e punëve. E dyta, se a bëhet verifikimi i të këthyerëve, po e shof se këtu kemi moskuptim të terminit reth të këthyerëve dhe të këthyerëve potencial? Të këthyer potencial janë ata që dëshirojnë të këthehen dhe ata aplikojnë në UNHCR në vendet e rajonit-Serbi e Mal të Zi dhe ata e përcjellin lëndën në UNHCR-së në Kosovë dhe Zyra jonë, bashkarisht me zyrën e UNHCR-së në Ksoovë në MKKthimit i takojnë personat e tillë. Nëse krijohen kushtet, ata persona këthehen, e nëse jo, ata edhe më tej e mbajnë statusin e të shpërngulurëve dhe të riatdhesuarëve. Për këtë e kemi përmendur shifrën prej 45 vetave që e kanë shprehur dëshirën për t'u këthyer e që ne parashtrijmë kushtet me kërkesën e dokumentacioneve. Pra, UNHCR-ja është organizatë unike. Këtu nuk është theksuar se ZLKKthimit merret edhe me çështjen e të këthyerëve nga Europa Pwerëndimore e, në rastet e këtilla, bashkëpunohet me MPBrendëshme të Kosovës. Për këtë, dalim në terren dhe kemi GP të Komunës i cili miraton vendime për ofrimin e ndihëmave. Sa i përket Raportit Financiar, raportet tona janë pjesë Raportit Financiar të Komunës dhe delegatët gjithmonë votojnë për atë Raport. Po theksoj se buxheti i Zyrës është 38 mijë euro, nga i cili 28 mijë u përkasin pagave e kemi 5 punëtorë e pjesa tjetër e mjeteve shkojnë për mallëra e shërbime. Zyra nuk disponon me mjete për investime kapitale dhe për këtë përmendet Amasada Amerikane në Beograd, fondi danez për 20 familje të këthyerë e që i ka përkrahur Ambasada e Amerikës në Beograd e për këtë ne nuk jemi fajtor që duhet të bashkëpunojmë, e për të bashkëpunuar, bashkëpunojmë me të gjithë dhe etiketat lidhur me lojalitetin tonë janë të panevojshme. Unë, personalisht, lojalitetin time e kam treguar në vitet e 90-ta, kur në mesin e parëve, e kam përkrahur luftën e shqiptarëve për pavarësi, për çka kam qenë i ndjekur dhe, më 1990, më është shkatërruar prona në Pejë. Sa i përket Kkomunitete, ata i kanë mbajtur takimet në Zyrën tonë e këto sulme të pozitës dhe opozitës tregojnë se ne jemi Zyrë e pavarur dhe ajo, edhe më tej, do t'i mbron interesat e komunitetit jo shumicë, në harmoni me ligjet e Kosovës, pavarësisht se sa do të na sulmoni dhe, ne, nuk jemi zyrë e strukturave paralele e ky është kualifikim ofendues, suidomos ndaj meje. Ne patjetër duhet të pranojmë njerëzit në Zyrën tonë, që të theksojnë problemet. Lidhur me bledhjet e anëtarëve të komunitetit jo shumicë në Zyrën tonë, po theksoj se ata kanë marr Vendim që t'i dërgojnë Shkresë kryetarit të Komunës, ku kanë paraqitur kushtet e tyre se, nëse nuk u plotësohen ato, do të ngrijnë pjesëmarrjen e mëtejme në këtë Komitet. Nga kjo arsye. Zyra dhe shefi i saj janë solidarizuar me anëtarët e këtij Komiteti. Pas një kohe, një numër janë këthyer në Komitet. Ajo se ku i kemi përcjell në Prishtinë ata që ankoheshin, po theksoj se atje ekziston Zyra për Ndihmë Juridike për cenimin e të drejtës së pronës sipas nenit 4, ajo Zyrë do t'u ndihëmon e nuk është e rrugës që ata që ankohen për cenim të drejtave të tyre t'u thuhet "s'ka problem" e mos t'u zgjidhen problemet, e nëse ne i mbrojmë të drejtat e qytetarëve, nga komuniteti shumicë mos të kuptohemi se jemi kundër tyre?! Ne jemi të obliguar të respektojmë ligjet. Edhe ajo

që është me rëndësi, u theksua se z.Mehmet Hamza është anëtar i Vakut-it, mund të them se ai nuk është fare anëtar i saj?!

z.Nexhat Isufi- Pas këtyre diskutimeve, unë po krijoj përshtypje tjetër dhe diskutimin e përfaqësuesit të Zyrës e kuptova plotësisht e mbetet të bëjmë njëfar balansi, por e di se kjo Zyrë duhet të kontrollohet nga ekzekutivi. Njëri nga kolegët theksoi se vetura e kësaj Zyreje është edhe të shtunave-dilave në shfrytëzim privat dhe para marketeve të caktuar etj., që është e vërtetë! Realiteti është se nuk po sulmohet komuniteti jo shumicë, po edhe ai shumicë, por parashtrohet pyetja pse kjo Zyrë nuk po kyçet për të ndihëmur në bartjen e mbeturinave dhe pastrimin e ambientit, nga se pjestarët e këtij komuniteti jo shumicë, kontejnerët i kanë gjuajtur në lumenjë e prrocka dhe në këtë Raport nuk po përmeden vizitat e bëra nga , Vuçiqi ,Vulini e të tjerët. Prandaj, tani po i drejtohem kryetarit dhe i them se mandati i tij është që të kontrollojë punëtorët dhe, nëse kjo Zyrë është që punon në interes të qytetarëve-goranëve, të punon për ta e jo kundër tyre, pasi se në këtë aspekt po del se po punon kundër tyre?! Kjo Zyrë duhet t'u thotë qytetarëve se për çka ka qëndruar Gjuriqi këtu dhe se a janë të njoftuar qytetarët se ekziston mjeku i cili këtu punon me reçeta e udhëzime të Republikës së Serbisë e, për këto raste, Zyra duhet të jetë e shqetësuar se veprohet me dokumentacion paralel dhe çka ka ndërhyrë kjo Zyrë që të mësohet gjuha e shumicës dhe ne jemi për integrimin tuaj, sepse ne si komunitet, shumicë jemi për mësimin gjuhës suaj, por që ju nuk po tregoni interesim për mësimin e gjuhës sonë-të shumicës?! Për këto çështje është e angazhuar kjo Zyrë e jo për atë "se sa pula paska dhuruar Ambasada Amerikane"?!

z.Granit Rifaj- Përfaqësuesi i Zyrës theksoi se kishte kërcnime të caktuara e, siç dihet, për këto vepra ka përgjegjësi ligjore. Duke e pasur parasysh se z.Mehmet Hamza e ka hartuar këtë Raport, unë kërkoj që ai, publikisht, të kërkon falje dhe duke e pasur parasysh situatën e këtillë, ai duhet të jep dorheqje në pozitën që ka, për presionet që paska, por jo nga komuniteti shumicë, por nga ai jo shumicë?! Ne theksuam se politika e Milosheviqit po realizohet këtu e nuk theksuam se jeni Zyra e Milosheviqit dhe dëshiroj të theksoj që ju mos t'i merrni gjërat personalisht, pasi se nuk jeni autor i këtij Raporti! Sa u përket ndërtimit të mini-hidrocentraleve, ju personalisht keni pjesëmarrës në inaugurimin e tyre dhe se dini mirë se prioritet të Komunës janë energjetika dhe turizmi dhe e kishit program zgjedhor të partisë?! Prandaj, në të ardhmen, kur të hartoni reporte të këtilla, mos paraqitni konstatime të këtilla, por tregoni se çka keni punuar e realizuar.

z.Artan Loshaj- Si duket, kjo Zyrë paska në duar edhe Policinë e Gjuqësinë dhe se janë të sigurt se kryesit e vjedhjeve qenkan nga Shqipëria, po del se ata bashkarisht paskan bërë vepra të këtilla, duke vjedhur?! Nuk mora as përgjigjen lidhur me shfrytëzimin 24-orësh të veturës së Zyrës se a e kanë të drejtën e këtillë zyrtarët e sajë?

z.Selman Osmani- Unë, në këtë Raport, m'uk po shof diçka të posaçme për ngritjen e tensioneve e këtu nuk shkruan asgjë për institucionet paralele që po përmendin kolegët. Në këtë Raport janë theksuar problemet me të cilat ballafaqohemi, për t'i zgjidhur bashkarisht. Mos t'i ngrisin

shumë tensionet dhe ka çka të flitet për vjedhjet në fshatrat e Gorës, nga se asnjëra nga ato raste nuk janë zgjidhur, ndërsa edhe ne ti japim sugjerime Zyrës që të jetë më e angazhuar. Nëse z. Velid H. qenka në lidhje e dijeni me vjedhjet e tilla, e dikush po i raportojska, unë s'di se çka mund të flitet? Edhe një herë, i lus kolegët mos të ngrisin tensione e të japim, për të ardhmen, kritika e sugjerime, që raportet, të janë më përmbajtësore. Mos të kuptohen gjërat se kjo Zyrë nuk po e përkrah komunitetin shumnicë dhe, nëse kjo Zyrë po bashkpunojska me qytetarët në terren, pse nuk interesohet nga Policia Rajonale në Prizren që të sigurohen patrullime në tërë territorin tonë? Përmendet bashkëpunimi me UNHCR-në e në Raport nuk vërjta sa ishte ai numër i të këthyreve? Të japim sugjerime e vërejtje se me çka duhet të merret Zyra e, me këtë rast, po e theksoj në problem që është paraqitur lidhur me regjistrimin në Librin e Shtetësisë. Pa u thellua në çështje mini-hidrocentraleve, unë do të theksoja se edhe për Krushevë janë bërë premtime, por që nuk janë pranuar nga përfaqësues të Vakut-it e ne nuk kemi asnjë ndriçim publik atje, siç kanë premtuar përfaqësuesit e "Euro-Kosit". Problemi qëndron edhe në uzurpimin e Zyrës së Komuniteteve nga përfaqësuesit e Vakut-it, ku nuk po mund të mbajm takimet e fshatit e që kryetari duhet ndërmarr diçka që ato të lirohen e funksionojnë normalisht, pasi se drejtori i DShëndetësisë aty e ka njëfar OJQ dhe i mban çelësat e Zyrës e ajo është jashtë funksionit?! Ne jemi këtu për zgjidhjen e problemeve dhe përfaqësuesi i Zyrës, me siguri, do t'i prezenton vërejtjet e kritikën tek shefi i Zyrës, që, në të ardhmen, raportet të janë sa më përmbajtësor dhe transparent.

z.Granit Rifaj- Fillimisht, desha t'i them kolegut-parafolës se nuk po ngrisin tensionet, por se nuk do të shukasim reth institucioneve paralele, dhe nuk po ngrisin tensionet nëse vehemi në mbrojtje të Komandatit legjendar Adem Jasharit, i cili është figura jonë nacionale e tensionet ngritet kur ofendohen figurat e tilla, ekzistimi i institucioneve paralele dhe vizitat e Vuçiqit dhe të atyre që deri dje na kanë masakruar. Prandaj, një Raport i këtill duhet të jetë marri për komunitetin tuaj, nga se ai krijon konflikte dhe urrejtje ndëretnike e qëllimi i ynë është që tensionet të ulen e që komuniteti juaj të integrohet, sa më shumë mundet, në shoqërinë kosovare. ☺

z.Velid Haxhisin- Unë, edhe në fillim, theksova se, ky Raport, është me mjaft konstatime paushale e që u vërtetu me nxitjen e këtyre reagimeve të shumëta. Unë, mendoj se më pak folëm për Raportin e më shumë për çështje tjera, siç theksoi z.Nexhat I. mbeturinat e për ato jemi përgjegjës të gjithë, duke filluar nga kyretari e më tej. Kompania kompetente është ajo e cila e ka sabotuar procesin dhe ka punuar të kundërtën, duke i revoltuar qytetarët, duke mos menaxhuar me mbeturinat. Nga ne është kërkuar të miratojm Rregullore për Mbeturinat, që ne e kemi bërë. Ai theksoi se, ndoshta, unë qenkëm përfaqësues i ndonjë shërbimi informativ, jo, unë këtë e kam dëgjuar nga përfaqësuesi i Zyrës Rajonale Policore se kryesi i vjedhjeve në Restelicë është nga Restelica e ku u vodhën 15 shtëpi e nuk e përjashtova mundësin që të janë edhe nga Shqipëria apo Maqedonia, apo ndonjë shtet tjetër? Mjerisht, ne kemi rastet e vjedhjeve ku janë përfaqësues të komunitetit jo shumicë nga fshatrat tona, si dhe kërkoj nga organet e rendit dhe drejtësisë që të angazhohen reth involvimit të institucioneve paralele në inskenimin e vjedhjeve që ndodhin, te ne.

z.Laurat Krasniqi- Për herë të parë po dëgjojmë se kjo Zyrë ekziston nga viti 2000 dhe se, për herë të parë, po i dërgon Raport Kuvendit? Ne këtu e kemi KKomuniteteve i cili paguhet për punën e vetë, që mendoj se debati i këtillë është dashur të zhvillohet atje e jo të vetëm të bëhet pagesa për pjesëmarrje në mbledhjen e Komitetit. Pra, këto debate janë dashur të zhvillohen në KKomunitet e jo të deabtetohet kaq gjatë në Kuvend i cili ka mundur vetëm të konstatoj. Kemi rastin që shumë raporte mos të na vijnë në Kuvend dhe se, ky Raport, tani po na ofron goditje në mest të individëve të partive politike të cilët, si duket, kanë edhe interesa personale? Pra, po del në shesh se, KKomuniteteve nuk po e kyren si duhet punën dhe, për këtë, po kemi Raport të këtill në Kuvend e tani po zhvillojmë debate të këtilla të panevojshme.

z.Vehbi Nazifi- Raporti ka qenë në KKomunitete dhe për, shkak të problemeve që u theksuan, e kemi edhe në Kuvend dhe nuk kemi pasur arsye që Raportin t'a ndalim në KKomunitete dhe, sa i përket Raportit, ai mund të jetë gjithçka, por jo Raport. Ai paraqet mendimet personale të kësaj Zyreje reth komuniteteve e mund të them se, më shumë është vlerësim i gjendjes, se sa Raport. Mendoj se Raporti është thjesht politikë e madje diku ka elemente të urrejtjes ndëretnike të cilët prishin harmonin e krijuar te ne, me vite. Kështu, pra, Zyrja është dashur të merret me çështje konkrete e jo me vlerësime e paragjykime. Shembull për këtë psh. është vlerësimi për vjedhjet, se gjoja vijnë nga Shqipëria e që doli e kundërta, e kjo Zyrë të merret me punët e këthimit dhe krijimin e kushteve për këthim normal të të këthyerëve

Kryesuesi- E përfundojmë debatin reth Raportit dhe kush është "për"-5, "kundër"-13 dhe 1 votë "e përmbajtur", që me këtë, Raporti nuk miratohet.

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Në pikën e V-të kemi shqyrtimin dhe miratimin e P/Vendimit për Ankandin Publik për shitjen e makinave jo funksionale të Komunës së Dragashit, hapim diskutimet...?

z.Samidin Xheladini- Një çështje të këtill e kam kërkuar edhe unë personalisht, si dhe mbar Kuvendi, sepse mendohet se do të ishte për të mirën e Komunës, nga arsyeja se ato makina janë stërvjetëruar dhe hargjojnë më shumë karburante e, në këtë mënyrë, mund të krijohet një fond kursimi për Komunën, që pra ne (LDK) jemi që ky proces të përkrahet.

Kryesuesi- Meqenëse po shifet se nuk kemi diskutime tjera, kush është për përkrahej e këtij P/Vednimi...?"për"-11, "konuër"-0 dhe "të abstenuara"-0 vota, që konstatoj se miratuam këtë P/Vendim.

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe lidhur me këtë pikë – P/Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës në pronësi të Komunës, hapim diskutimet...?

z.Velid Haxhisin- Edhe në seancën e kaluar kam thërksuar se unë nuk kam asgjë kundër dhënies së lokaleve të me qira, natyrisht, për kohëzgjatje të shkurtër, pasi se, më mirë, do të kontrollohej qiraja. Por, po theksoj prap se ekzistojnë lokale nëpër fshatra të cilët shfrytëzohen, por pa kontrata, që do të thotë kemi shfrytëzime ilegale të pronës komunale, si dhe kemi lokale të cilave, çdo vit, ju vazhdohet kontrata e se di si, sipas cilit Ligjit, dhe propozoj që kryetari t'i urdhëron Inspektionit që të evidentohet lokalet e tillë dhe të shifet se çka më tej? Pra, a do të shfrytëzohen më tej, apo do t'u lehen fshatrave, që të vendosin?

z.Samidin Xheladini- Ndoshta, nuk kemi informate se kush i shfrytëzon lokalet e tilla, por, gjithsesi, e përkrahim këtë P/Vendim dhe mendoj se Auditori ka dhënë rekomandime edhe lidhur me këtë, që mendoj se kjo mund të shërbej si fillim i zgjidhjes së këtyre çështjeve.

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi diskutime tjera, kush është për miratimin e këtij P/Vendimi...? "të gjithë"-19, pra miratohet "unanimisht" miratohet ky P/Vendim.

Pika e VII (shtatë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën, urdhëroni, paraqituni në kadër të pikës së VII-të ku kemi Kërkesën e KF "Opoja" për mblulimin e shepenzimeve të garave, hapim diskutimin....?

z.Laurat Krasniqi- E kam lexuar Kërkesën dhe, në fillim, mu duk si shumë e lartë shuma që kërkohet dhe pse, ky Klub, e ka një histori të funksionimit. Ai është OJQ dhe të dërgon rezultat e punës së deritashme në kuadër të aktiviteve të veta. Kërkesat, si kjo, vazhdimisht po shtohen dhe për këtë përkrahja e Komunës nuk ka munguar, me sa e di unë? Mendoj se zyrtarët e këtij Klubi, këtë Klub, e kanë shëndërruar si të jetë personal, nga se ai nuk ka Bord, apo çfardo struktura për të raportuar ndaj dikujt? Është rrezik të përkrahet një klub i cili duket si pronë private, si dhe kemi edhe klube tjet privat të cilët, po ashtu, përfitojnë një përkrahje direkte përmes KPFinanca dhe, edhe përkundër se ata kanë bërë kërkesa, kërkesat e tyre nuk i janë dërguar Kuvendit. Dhe, nëse kjo Kërkesë ka ardhur në Kuvend, është dashur të përcillen edhe kërkesat e klubeve tjerë. Prandaj, mënyra në të cilën aktualisht funksionon Klubi, mendoj se nuk meriton të përkrahet?

z.Vehbi Nazifi- Të merresh me sport është kënaqësi, pasi se disa nga ne jemi marr me sport. Kërkesat e KF-ve janë të vazhdueshme, e kësaj radhe, kemi Kërkesë zyrtare dhe mednoj se nuk është dashur të vij te ne, pasi se nuk i dijmë as kodet, se nga do të sigurohen mjetet? Po theksoj se Kuvendi, regullisht, që nga viti 2013 i ka përkrahur KF-ve dhe mendoj se duhet biseduar për gjendjen e tërësishme në KF "Opoja" e që disa çështje apostrofoi kolegu parafolës. Nuk e di si funksionon ky Klub, si OJQ, apo organizatë tjetër? Prandaj, sot futbollit nuk po shikohet si sport, por si biznes dhe, nëse nuk e ka vizionin që të arrin suksese më të mëdha, atëherë ky Klub nuk ka perspektivë. Në bazë të bisedave me lojar të këtij Klubi shifet se nuk ka seriozitet për këtë, pasi se atyre u mungon shkolla e futbollit e lojtarët e Klubit janë serioz dhe u dëshiroj suksese, dhe, nëse nuk ndërmarrim masa që të ndryshohet statusi i këtij Klubi, psh që të shëndërrrohet në shoqëri aksionare, atëherë edhe bizneset

do të investojnë në këtë Klub. Kështu, nëse nuk përkrahen shkollat e futbollit, ky Klub do të vjen në situatë që nuk do të ketë lojtarë. Pra, të shifet e të diskutohet statusi i tij, rregulloret dhe dokumentacioni tjetër. Unë, përndryshe, jam për përkrahje, por duhet ditur se nuk janë në pyetje 8 mijë por 16 mijë euro, pasi se e kemi edhe sezonin tjetër. Ne, gjithësesi, duhet t'i kemi parasysh edhe rregullat e FIFA-së, që mos të vihet deri tek format e e konfliktit të interesit.

z.Sefin Mejzini- Edhe ne si GP i LDK-së, parimisht, jemi që Klubi të ndihëmohet, por aq sa lejojnë bazat ligjore. Duhet të kemi parasysh faktin se ekzistojnë edhe 2 klube, përkatësisht, shkolla të futbollit të cilat janë themel i këtij Klubi dhe se, pa shkolla të futbollit, nuk ka Klub. Kam informata se edhe ato u kanë parashtruar kërkesa KPFinanca dhe kërkoj që mos të aplikohen "standarde të dyfishta"?

z.Nexhat Isufi- Edhe më herët kemi pasur kërkesa të këtilla dhe disi jemi gjetur. Edhe përkundër asaj se ky Klub është OJQ, këta janë njerëzit tonë dhe e përfaqësojnë komunën tonë. Ne, deri tash, i kemi ndihëmuar me 2 apo 3 mijë euro dhe e dijmë se Klubi e ka kaluar një fazë-grupi i 3-të "A". Unë janë për ndihëmesë, por duhet të profilizohet si Klub. Unë i kam përcjellur disa nga garat dhe ata, vërtetë, kanë nevojë për përkrahje, por ne jemi komunë e varfër, por që duhet të dijmë se ata janë "ambasadorët" tonë të cilët na përfaqësojnë-kudo dhe t'i përkrahim aq sa mundemi, me kërkesën që të njoftohemi me statusin, të hyrat e të dalurat, donacionet etj. që të dihet se ku janë e ku jemi?

z.Laurat Krasniqi- Për secilin lloj të taksave të qytetarëve duhet kërkuar përgjegjësi e nga KF "Opoja" askush nuk ka kërkuar kurrfar përgjegjësi. Të na dërgojnë raporte dhe të shofim se janë transparent në shpenzimet e tyre. Kemi kërkesën për 8 mijë euro e ti përkrahim e për këtë nuk janë në dijeni lojtarët për t'a ndarë si duhet e një person po planifikon, ka vulën dhe vendos vetë?! Jam, parimisht, për përkrahje por jo në këtë mënyrë, pasi se ata do të vazhdojnë me të vjetrën. Pra, të dërgojnë objektiva të qarta, që të dihet qartë se si punohet, pasi se, në këtë mënyrë, do të kemi edhe kërkesa tjera të klubeve, e atëherë, do të jemi në situata të paqarta?

z.Shpejtim Hajredini- Në njëfar mënyre, jam i befasuar nga kolegët të cilët janë kundër finansimi të një klubi i cili na përfaqëson. Mendoj se këto shënime që i kanë paraqitur në Kërkesë janë të ulët për t'u paguar, siç theksohet për gjyqtarët, transport-vbetëm 40 euro etj. që gjithsdejt janë 8 mijë euro për 6-mujorine parë. Pra, mendoj se kjo shumë nuk është e lartë që të përparon Klubi. Ndoshta e keni kuptuar gabimisht, por Klubi është në ligën e III-të e mendon të jetë në të II-tën dhe përkrahje e jonë është vendimtare, natyrisht nëse kjo nuk është në kundërshtim me rregullat e finansimit. Nëse nuk vazhdojmë t'i ndihëmojmë, ata do të pësojnë rënie në pozicionin ku janë. Ndërkaq, sa u përket shkollave të futbollit, me sa e dijë unë, ata finansohen vetë përmes turnirëve të caktuar e çështjeve tjera, kurse ky KF është i vetmimi i cili na përfaqëson, edhe pse si OJQ,

z.Munir Jonuzi- Pa keqkuptime, të gjithë jemi për përkrahje të klubeve tona dhe, siç theksoi kolegu mëjherët, ata janë "ambasadorët" tonë dhe na përfaqësojnë në të gjitha nivelet e garave dhe. Momentalisht, janë në ligën e II-të e që është për lavdatë. Dje në KKomunitet, kryetari na ka thënë se mjetet do të ndahen, nëse vendosim në nga pozicioni buxhetor i mallërave e shërbimeve. Nëse e shiqojmë Raportin 6-mujor financiar, do të shifet se kjo kategori është më e latë për 180 mijë euro se vitin paraprak dhe parashtrohet pyetja se si do të ndahen mjetet që nuk i kemi paraparë me buxhet. Klubi është OJQ dhe, ndoshta, është mënyra e vetme për t'u regjistruar dhe duhet ditur se komuna e Dragashit ka me djetëra OJQ të cilat mund të na dërgojnë kërkesa të tilla dhe mendoj se kërkesa të këtilla janë të pa nevojshme, nëse kemi rregullore të mira e që mjetet për këto çështje do të orjentoreshin në DKRS, që ata të disponojnë me to e jo që OJQ-të të na dërgojnë vazhdimisht kërkesa të tilla.

z.Velid Haxhisin-Kësaj radhe po theksoj se pajtohem me kolegun Laurat K., ndoshta për herë të parë, por për konstatimin e tij se KKomuniteteve nuk është dashur të lejon që Raporti i tillë për ZLKKthimit të përcillet në Kuvend e që pajtohem se edhe KPFinanca nuk është dashur të lejon që, edhe Kërkesa e KF "Opoja", mos të vij në Kuvend. Për këtë ne e kemi miratuar Rregulloren e Subvencioneve e ku parashihen gjërat dhe ne e dijme se me çfar buxhet disponojmë në subvencione dhe është e pamundur që të kënaqen nevojat nga ai pozicion. Pra, unë jam për ndihmesë këtij Klubi, por të merren parasysh edhe klubet tjera e OJQ-të, në rastet e manifestimeve të ndryshme. Nëse bëjmë përjashtim që të intervenohet nga pozicioni i mallërave e shërbimeve, ai përjashtim, ndoshta, mund të vlen edhe për të tjerët e mos të vijmë në situata të palakmueshme. Atëherë, kur ne jëzëz mësuan se kemi Rregullore për Subvencionet, filluan masovikisht të paraqiten me kërkesa e që, në mungesë të mjeteve të mjaftueshme, nuk mundëm t'i kënaqim të gjitha nevojat. Unë, parimisht, jam për ndihmesë këtij Klubi, por jo me shumën e kërkuar, por që kryetari të pëcaktohet brenda mundësive buxhetore, qoft edhe përmes KPFinanca, pasi se shuma është e madhe.

z.Zinaida Elmazi- KF "Opoja" është themeluar në vitin 2013 me iniciativën e veteranëve të sportit me iniciativë të të dy komuniteteve e pasi se kemi tri komunitete dhe se ai boshnjak përbën 35% të banorëve, si mendoni se unë do t'a përkrahi Kërkesën? Unë e përkrahi sportin dhe menifestimet kulturore, por kjo Kërkesë është e tepërt, pasi se mjetet i kemi të limituara. Përmes KPFinanca, ky Klub, ka përfituar 2-3 mijë euro e dy klubet tjera nga 500,00 euroe tabni prap paraqitet me Kërkesë e unë nuk kam asgjë kundër që të rinjë të merren me sport, se sa me disa veprime tjera të dëmshme, por nesër do të jemi në situata që të kërkojnë edhe tjerat OJQ qoft për sport apo manifestime kulturore e të tillat janë të shumëta. Mendoj se duhet gjetur mundësi, nga se kjo duket si diçka private dhe nuk shof arsye që të finanson Komuna këto aktivitet? Dhe, nëse nuk mund të sigurojnë mjete financiare, mund të sigurohen dresa e paisje tjera sportive, por në emër të të tri komuniteteve tona.

z.Samidin Xheladini- Sa u përket përkrahjeve të klubeve, kjo premtohet kur është në pyetje aktiviteti zgjedhor dhe secili kandidat paraqitet me "program" e ne si Kuvend duhet të jemi të balansuar për të gjithë dhe mënyra e finansimit duhet të përcaktohet nga qeveria lokale, duke pasur parasysh faktin se edhe vetë kryetari ka qenë sportist i dalluar dhe të gjen mundësi që Kërkesa të përkrahet. Ne jemi për përkrahje dhe kemi biseduar me GP (LDK) që klubet të përkrahen, por jo që për "dikend të jemi nënë e për dikë njerë" e kjo duhet të rregullohet me forma të dokumentacioneve përkatëse.

Kryetari- Diskutimet e juaja janë të arsyeshme dhe ka disponim që të ndihëmohet ky Klub. Është tejet vështirë të ofrohet zgjidhje aftgjate për ndonjë klub sportiv apo SHKA, pasi se kjo nuk është e rregulluar me dokumentacion për funksionimin e qeverisjes lokale, por përmes OJQ-ve ku përfshihet edhe ky Klub. Ky Klub është OJQ, por për ne është diçka më shumë që na identifikon-si Komunë. Sot kemi Kërkesën për mbulim të shpenzimeve, si transporti, apo pagesa e referëve dhe çështjeve më të domosdoshme e që, edhe deri tash, jemi munduar t'i ndihëmojmë. E vetmja shpresë ngel miratimi i Ligjit ,që mjetet tu dedhen drejtorateve të KRS-së, apo përkrahja e tyre përmes bizneseve të interesuara, si dhe me lirimi nga taksat e disa obligime tjere që mundet ligjërisht. Ne për transport kemi intervenuar, por që po na krijohen më shumë shpenzime me karburat, mirëmbajtje të automjeteve, apo mëditjeve për shoferët gjatë vikendeve. Me miratimine Vendimit për këtë, ne do t'i evitonim shpenzimet për remont dhe amortizim të automjeteve. Realisht, për t'u ndihëmuar, ka nevojë edhe për dy klubet tjera-shkolla të futbollit. Të shpresojmë se, edhe me një UA për përkrahje bizneseve, do të ndikohet në mbijetesën e klubeve sportive. Në këtë kontekst, po thesjoj se nesër presim arritjen e Ministrit të MKRSportit i icli na ka premtuar 700 mijë euro, për vazhdimine punimeve në sallën e sporteve dhe 100 mijë pëe vazhdimine punimeve në stadiumin e qytetit, për çka presim nënshkrimin Memorandumit, që do të thotë se do të ketë mjaft investime në sport, dhe kërkoj miratimin e kësaj Kërkesë.

Kryesuesi- Në rregull, kalojmë në votim të Vendimit dhe kush është "për"-16, "kundër"-0 dhe 2 vota "të përmbajtura", pra-nga shumica e të pranishëve dhe miratohet Vendimi i këtillë për KF "Opoja".

Pika e VIII-të (tetë) e rednit të ditës – "eventuale"...

Kalojmë në pikën e VIII (tetë) dhe të fundit të seancës-"eventuale", urdhëroni...

z.Naser Murtezani- Do t'i parashtoj disa kërkesa të qytetarëve të komunës së Dragashit, përkatësisht të trevës së Opojës. E para, lidhur me tregun në Bresanë i cili mbahet, një herë në javë, e ku qytetarët ushtrojnë veprimtaritë tregtare. Për këtë, qytetarët kërkojnë menaxhim më të mirë të tregut, sidomos fermerët të cilët kanë nevojë të shesin bagëtite e tyre, e në veçanti tani kur është në prag festa e Kurben-Bajramit e nuk lejohet therja e bagëtive e nuk ka mjaft hapësirë për shitjen e tyre. Po ashtu, problem janë edhe automjetet të cilat parkohen pa kurrfar rregulla. E dyta, kemi investime

të caktuara nëpër fshatra, e shumë fermerë, nuk i kanë rrugët për në fermat e tyre dhe të tillë janë fermerët e f.Zaplluxhe e që kërkojnë realizimin e kërkesave të tyre, pasi se kanë vështirësi-sidomos dimërit. E treta, gjatë fushatës suaj zgjedhore kemi dëgjuar se priritet i pushtetit do të jetë bujqësia e blegëtoria e, para dy muajëve, kemi pasur një rast të fermerit nga Opoja i cili ka pasur dëme në bagëti dhe a keni ndërmar diçka? Edhe një çështje, lidhur me rrugën: Zaplluxhe-Lez-Prizren, sidomos në dy vende ku vështirë kalohet e që duhet t'a keni në konsideratë, për të mirën e qytetarëve.

z.Velid Haxhisin- Meqenëse jemi në kohën kur te qëndron diapsora dhe kur mbahen gëzime familjare, ngjan ndërprerja e shpesht e energjisë elektrike, për shkak të defekteve, si dhe (mos)lirimi i rrugëve nga automjtet, unë këtë nuk e kuptoj ndryshe, pos si presion në diasporën tonë të cilët ankohen se nuk dëshirojnë të këthen në vendlindje?! Mendoj se KEDS-i po silllet në mënyrë tejet të pa përgjegjshme kur është në pyetje sezona e pushimeve verore dhe se ekipet nuk po janë azhure në terren e defektet janë të shpeshta e kemi të bëjmë me njerëzit tonë që organizojnë ahengje familjare e duhet të nxitonjë për të siguruar gjenerator të rrymës e, për një defket në trafo-stacion, pritet nga 2-3 ditë, u prishen akulloret e mishërat tregtarëve e familjeve etj. Unë këtë e kam theksuar edhe në KKomunitete, por e shfrytëzoj edhe tani rastin kur i kemi edhe mediat këtu se dikush nga përgjegjësit e KEDS-it do t'i dëgjoj shqetësimet, për të ndërmarr diçka. Në të kundërtën, diaspora jonë do të humb interesimin për të qëndruar në vendlindje për pushime vjetore.

z.Samidin Xheladini- Prap po më duhet të reagoj. Ju të tre (kryetari, nënkryetari e kryesuesi) jeni nga Bresana, dua të theksoj se pse nuk po rregullohet ura atje-bashk me rrugën e për këtë, pos juve, qytetarët më akuzojnë edhe mua, pse nuk e paskëm theksuar çështjen këtu-në Kuvend e kjo le të jetë dëshmi?!

Kryesuesi- Kam marr informata nga ana e inxhinierit se uji i cili kalon nën urë është sasi e madhe e, për këtë, nuk po punohet tani te ura.

Kryetari- Do të përpiqem të jap përgjigje në pyetjet e parashtruara. Sa i përket tregut në Bresanë, po theksoj se ka pasur kërkesa të caktuara e që ajo të dislokohet nga ura e çështe tjetër është menaxhimi i saj nga Komuna e ajo, si e tillë, nuk është e regjistruar e është e shëndërruar, vetvetiu, në treg, por kjo nuk do të thotë se diçka nuk duhet ndërmarr. Ne mund të dërgojmë Shërbimin e Inspektionit me rastin e ditëve të tregut, që të rregullon trafikun dhe vendet për treg, përfshi edhe vendet për fermer ku do të ekspozonin bagëtitë e tyre, ata që shesin dru etj. e që duhet një Plan i posaçëm i menaxhimit, por që disave që vijë aty, nuk u ka konvnuar? Do të mundohemi të vendosim rregull parçiale e gjatë festave dhe pushimeve verore ngjan që të ketë tolli më të mëdha, e jasht sezoneve, nuk ka probleme. Sa u përket investimeve dhe hapjen e rrugëve për në ferma, kjo çështje qëndron dhe ka nevojë të ndërmerren masa për depërtim në ato ferma. Ndërkaq, kur caktohen priritetet në investime kapitale, dihet se kjo iniciativë rjedh nga vetë udhëheqësitë e fshatrave e që kjo vlen edhe lidhur me rrugët për në ferma, që ne nuk do të kishim asgjë kundër. Ne tani jemi në fazën e leximit të buxhetit e, si priritete, mund të paraqitni propozimin për rrugë në ato

ferma. Është e vërtetë edhe ajo se, gjatë fushatës sime zgjedhore, kam premtur si prioriteve bujqësinë e blegëtorinë dhe lidhur me këtë kemi pasur aktivitet të caktuara në ndarjen e bagëtive përmes UNDP-së, si dhe thirrje për dorëzimin e projekteve për makine lopë jelëse e që, në njëfar mënyre, jemi në funksion të atyre premtimeve zgjedhore. Ndërkaq, sa u përket intervenimeve përmes subvencioneve në bujqësi, ju e dini se ne si Komunë, nuk e kemi këtë mundësi, pasi se kjo çështje vjen nga niveli qendror. Lidhur me atë rast të dëmit të fermerit nga Bresana, ju e dini se Komuna nuk ka mjete të parapara buxhetore për rastet e tilla të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, pos të ndonjë ndihëme simbolike. Po të kishte mundësi, pse mos të ndihëmohej edhe këto raste, por që nuk e lejojnë rragullat. Sa i përket rrugës Zaplluxhe-Prizren, ne jemi në kontakte të vazhdueshme përfaqësues të MInfrastrukturës dhe se edhe ne jemi investues në atë rrugë dhe kemi obligime dhe atë rrugë e kemi përfshi në listën e rrugëve nën kompetencë të Komunës, por që, ndonjëherë, procedurat po vonohen e nuk po japin efekte të duhura, pasi se rruga është ngushtuar aq sa paraqet rrezik. Ne, si komunë, nuk kemi gjithaq mjete, nga se ajo rrugë ka koston më të lartë. Reth ndërprerjeve të energjisë elektrike, unë me 3 përfaqësues tjer të Komunës, kam qenë në kontakte me KEDS-in në Dragash, që janë zotuar se do të ndërmerren masa për përmirësim të gjendjes e cila brengos. Naga ata kemi kërkuar që pastrimi i trases së përçuesëve të bëhet jasht sezonit veror-pranverës e vjeshtës e jo kur kemi këtu diasporën këtu e kjo ndikon direkt edhe në marrjen me veprimtari biznesi. Sa i përket urës në Bresanë, edhe mua më janë dërguar kërkesa të qytetarëve, por operatori e ka dinamikën e punimeve dhe atë duhet t'a respekton e, gjithësesi, problemi ka qenë në volumin e ujit gjatë këtyre ditëve me të reshura, por që mendoj se ajo do të përfundon, siç duhet.

z.Nexhat Isufi- Kemi dëgjuar se është në prag realizimi i investimeve në këtë sallë të Kuvendit, deri ku është arritur?

Kryetari- Janë bërë paramasat e paralogaritë, është publikuar tenderi për rinovimin e saj me ankesin dhe mednoj se do të bëhet mirë, duke e marr tenderin ndonjë firmë serioze e që do të rregullohet edhe zërimi, nxemja etj. Të shfrytëzohj rastin të ju njoftoj se e kam pasur një mysafir nga Turqia e në pyetje është bashkëpunimi ynë me komunën e Bursës në Turqi e ata kanë pasur një memorandum me komunën e Malishevës. Në pyetje është regjioni Regjep Gunduz i saj e ne duhet të nënshkruajmë një Memorandum bashkëpunime me ta.

z.Sefidin Mejzini- Kam edhe një kërkesë për kryetarin se nuk është në rregull që të rregullohen rrugët në Kosovë e të lehen anash 7 probleme tjera të parregulluara se kanë ngel anash. Ato rrugë kanë filluar të kubëzohen në vitin 2017 e Vendimi juaj për mos kubëzim të pronave është i vitit 2018 e rrugët kanë ngel të pa kryera e në gjetjet e Auditorit theksohet se janë paguar 12 mijë euro, pa kryerjen e punimeve e kjo nuk është në rregull?!

z.Granit Rifaj- Çka është puna me pronën e Komunës nën pronësi të AKP-së, pasi se kemi dëgjuar në media se pronat u janë këthyer komunave?. Prandaj, dëshiroj të di se, ne si Komunë, a kemi parashtruar Kërkesë për rikthim të pronës komunale? E dyta, ka qenë tenderi për f.Bellobrad e

ishite paraparë vendosja e 5 "policëve të shtrirë"-te shkolla dhe në vende tjera, e ne tani, në bashkëpunim me këshillin e fshatit, kërkojmlë vendosjen e tyre me përfundim të projektit e që nuk po na thuhet "jo", por nuk ka ende asgjë konkrete? Po ashtu, lidhur me muzikën që po organizohet natën, do të ishte mirë të rregullohet kjo me Rregullore e kështu do të lehtësohej puna e pushtetit lokal me arstin e (mos) dhënies së pëlqimeve?

Kryetari- Ajo që theksoi z.Sefidin M., edhe, për mua pesonalisht, situata është e pa këndëshme, pasi se gjysma e punës ka ngelur pa kryer. Mua më intereson ajo lidhur me mjetet dhe unë e di se punënkryesi ka marr mjetet, për ate që ky kryer, dhe ai Vendim që kam miratuar, për mioskubëzimin e pronave private, edhe mua më ka shkaktuar probleme, por kam qenë i detyruar t'a bëj e që duhet të punojmë diçka duhet, por kemi probleme për shkaqe të njohura. Po theksoj se kryetarët e komunave kanë pasur takim me Kryeministrin dhe jemi njoftuar se është miratuar Ligji për Rikthimin e pronave komunale në pronësi të AKP-së, komunave të Kosovës, dhe pritet miratimi i tijë në Parlamentin e Kosovës. Për komunën tonë kjo do të jetë e mirëseardhur, pasi se do të kemi mundësi të ndërtojmë e investojmë, siç kemi rastin me nevojën e ndërtimit të stadiumit. Duhet të dihet se fshatrat nuk kanë pronë të tyre dhe se prona mund të jetë vetëm private apo shoqërore. Kur të përfundon ky proces, do të shofim se çka me veprua me pronën e rikthyer Komunës. Te vendosje "policëve të shtrirë" për këtë ekzistojnë rregullat e Departamentit të Rrugëve, por, gjithësesi, nuk ia vlen të kursehet, kur janë në pyetje jetërat e njerëzëve.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk kemi edhe diçka, me këtë përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu